



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 53 (827751)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 31 Dhjetor 2021

Festimet e Vitit të Ri me fëmijët e prindërve nën uniformën ushtarake

Ministri Peleshi: I lumtur që jam sot mes jush, e ardhmja jonë!



» faqe 3

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu:
Profesionalizmi i treguar dhe
eksperiencat nga misionet e kaluara,
e kanë bërë strukturën EOD
një strukturë profesionale dhe
specialitet "niche", siç e quan NATO



» faqe 4

Nga Elbasani nis rekrutimi për ushtarë/detarë

Ministri Peleshi: Ne, sot i shikojmë në sy të gjithë të rinjtë të cilëve iu drejtojmë ftesën për t'u bërë pjesë e FA-së

*Ministria e Mbrojtjes: Fushata e rekrutimit, si duhet të aplikojnë dhe
kriteret që duhet të plotësojnë të rinjtë për t'u bërë pjesë e FA-së* » faqe 2-3



Platforma dixhitale

**"E-Albania", portali që iu
shërben të gjithëve, civilë
dhe ushtarakë**

Në Qendrën e Arsimit Profesional të
Nënoficerëve u mbajt një brifing njohës mbi
funksionimin e Platformës dixhitale e-Albania.
Brifingu njohës u mbajt nga Toger Sonila Zhu-
pani, në të cilin u fol mbi shërbimet që ofron
e-Albania, benefitet që kemi ne nga shërbimet e
ofruara nga kjo platformë e qeverisë dhe mënyrën
sesi mund të aksesojmë për përdorimin e kësaj
platforme, për të gjitha nivelet e shërbimit...



» faqe 5

96 vjet Forca Detare

**Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia: Forca Detare ka
kryer me sukses detyrat e ngarkuara kombëtare,
rajonale apo edhe në kuadër të Aleancës**

Doktrina e Forcës Detare, si pjesë e Doktrinë
së FARSH ka karakter mbrojtës, i cili sank-
sionohet në qëllimin parësor strategjik të FARSH,
që është: "Ushtrimi i sovranitetit të Republikës së
Shqipërisë; Mbrojtja e pavarësisë dhe integritetit ter-
ritorial; Mbrojtja e jetës dhe e pasurisë së shtetasve,
zhvillimi i pandërprerë demokratik dhe prosperiteti
ekonomik; Mbrojtja e dinjitetit dhe e vlerave kom-
bëtare; si dhe integrimi..."

» faqe 6-7

NISIN REKRUTIMET PËR USHTARË/DEJARË NË FORCAT E ARMATOSURA

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Për FA rekrutimi i ushtarëve me një profil sa më të lartë, në përmbushje të detyrave në mbrojtje të vendit dhe në interes të Aleancës

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi njoftoi çeljen e procesit të rekrutimit, duke theksuar se “ofrohen kushte pagese dhe trajnimi si asnjëherë më parë”. Ministria e Mbrojtjes e konsideron thelbësor, për Forcat e Armatosura, rekrutimin e ushtarëve me një profil sa më të lartë, në kushtet e një profesionalizmi më të lartë të FA-së dhe një angazhimi gjithnjë e më të madh në përmbushje të detyrave në mbrojtje të vendit dhe në interes të Aleancës. Pjesë e këtij procesi mund të bëhet çdo i ri nga mosha 18

vjeç deri në 27 vjeç, që nuk ka probleme me ligjin, që ka një figurë të pastër morale, që nuk është person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes janë publikuar të gjitha kriteret që kërkohen për procesin e rekrutimit, ku përcaktohet edhe kalimi i tre testeve: ai fizik, intelektual dhe psikologjik, që do të kryhet në faza të caktuara.



Rekrutimi

Rekrutimi i ushtarëve me një profil sa më të lartë është thelbësor për Forcat e Armatosura. Ndaj Ministria e Mbrojtjes përcakton si pjesë të kriterëve, që duhet të plotësojnë të gjithë të rinjtë e të rejtat, një profil cilësor, të aftë nga ana fizike dhe shëndetësore dhe me një nivel të lartë kulturor.

Për të filluar procesin e rekrutimit çdo i interesuar duhet të plotësojë edhe një sërë dokumentesh:

Djemtë dhe vajzat nga mosha 18 vjeç deri në 27 vjeç me arsim 9 - vjeçar, të mesëm apo të lartë mund të aplikojnë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, ku një pjesë e veçantë i është dedikuar rekrutimeve. Procedurat e përzgjedhjes së ushtarëve/detarëve do të jenë transparente dhe të dokumentuara.

Të rinjtë do të kalojnë edhe tre teste; atë fizik, intelektual dhe psikologjik që do të kryhet në faza të caktuara.

Veç trajtimit financiar, çdo i kualifikuar për të vijuar karrierën brenda Forcave të Armatosura do të gëzojë edhe një sërë mundësish:

- të ardhura mujore dinjitoze, si asnjëherë më parë për FA,
- arsimim dhe aftësim profesional në vazhdim, brenda dhe jashtë vendit,
- përgatitje fizike sipas standardeve të NATO-s,
- trajnime dhe stërvitje jashtë vendit së bashku me kolegët e tjerë të NATO dhe SHBA, e të tjera përfitime.

Ministria e Mbrojtjes: Fushata e rekrutimit, si duhet të aplikojnë dhe kriteret që duhet të plotësojnë të rinjtë për t'u bërë pjesë e FA-së

Veç trajtimit financiar, çdo i kualifikuar për të vijuar karrierën brenda Forcave të Armatosura do të gëzojë edhe një sërë mundësish



Ministri Peleshi: I lumtur që jam sot mes jush, e ardhmja jonë! Singeriteti juaj fëmënor na bën të reflektojmë në të rriturit se sa detyrë të rëndësishme kemi në rrugetimin tuaj të gjatë. Gëzuar, suksese ju dhe prindërve tuaj!



Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u organizuan nga sektori i aktiviteteve, pranë QKMBMMFA, festimet e vitit të ri me fëmijët e prindërve nën uniformën ushtarake. Në këtë aktivitet morën pjesë ministri i mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i shtabit të përgjithshëm gjeneral major Bajram Begaj. Të cilët uruan fëmijët për sa më shumë shëndet dhe suksese, si dhe falënderuan prindërit e tyre për përkushtimin dhe devotshmërinë e treguar në këtë vit të vështirë. Më pas mes këngëve fëmënore u shpërndanë dhurata nga të pranishmit.

Nga Elbasani nis rekrutimi për ushtarë/detarë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Ne, sot i shikojmë në sy të gjithë të rinjtë dhe të rejtat të cilëve iu drejtojmë ftesën për t'u bërë pjesë e FA-së

“Kemi arritur t'i japim një drejtim dinjitoz dhe një pagë të niveleve si ajo e aleatëve tanë”

Nga Elbasani nisi procesi i rekrutimit për ushtarë/detarë në Forcat e Armatosura. Pjesë e aktivitetit ishin ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bajram Begaj, kreu i bashkisë së Elbasanit dhe deputetë të qarkut. Gjatë fjalës së tij, ministri Niko Peleshi e cilësoi tejet të rëndësishme këtë fushatë. “Ne, sot i shikojmë në sy të gjithë të rinjtë dhe të rejtat të cilëve iu drejtojmë ftesën për t'u bërë pjesë e FA, sepse kemi arritur t'i japim një drejtim dinjitoz duke filluar nga paga. Siç e dini kemi një rritje prej 30%, një rritje të sheshtë, që do të thotë rritje nga ushtari i parë tek gjenerali; një rritje 30% të pagës që do të thotë: ai që sot rekrutohet në ushtri merr një pagë më shumë se 50 mijë lekë të reja që në momentin e parë por nuk është vetëm kjo: së pari të jesh kontributor në FA do të thotë që të bësh pjesë në atë fashë të qytetarëve shqiptarë, të cilët janë sot për sot më të kuotuarit në opinionin publik sipas të gjitha sondazheve, pyetësorëve, institucioni ku qytetarët besojnë më tepër janë FA”, -theksoi ministri Peleshi.

Më tej në fjalën e tij ai shtoi se FA-të kanë një prezantim dinjitoz në misionet e NATO-s prej më shumë se 20 vitesh në zona si Afganistani, Iraku, Kosova, Bosnja, Afrika apo Letonia.

FA me të vërtetë është krenari



dhe ne sot përmes këtij eventi që po fillojmë në Elbasan dhe do të shikojmë në të gjithë Shqipërinë, duam ta sjellim më pranë publikut atë çka janë FA-të, mundësitë që ofrojnë dhe mbi të gjitha krenarinë dhe nderin që të shërbesh në të”, -tha ministri i Mbrojtjes.

Duke ftuar djemtë dhe vajzat të bëhen pjesë e FA-së përmes këtij procesi rekrutimi, ministri Peleshi tha se ata kanë mundësi të ngrihen në karrierë dhe të përfitojnë nga trajnimet brenda dhe jashtë vendit. “Djem, vajza dhe ushtarakë, të cilët në varësi të shkollimit



të tyre dhe të dëshirës për të ecur në karrierë, nuk bëhet fjalë vetëm për të filluar dhe shërbyer deri në fund të jetës së tyre profesionale si ushtar bazë, por kanë mundësi të ngrihen si Ushtar i Parë, Ushtar i Dytë, Ushtar i Tretë, Ushtar i Katërt dhe pastaj,

nëse kanë një shkollë të mesme, është linja tjetër e karrierës, apo ata që kanë një shkollë të lartë duan të përfitojnë nga kurset e oficerit, kurse të shumta brenda vendit jashtë vendit, SHBA apo vende të tjera aleate të NATO-s kanë mundësinë që të arrijnë pse jo edhe në gradat më të larta të vendit. Sot për sot, do të thosha, sistemi ka shpërblimin më dinjitoz edhe në terma page, por edhe në terma morale”, -tha z. Peleshi.

Fushata e rekrutimit ka nisur edhe në Tiranë dhe do të vijojë deri më 20 janar 2022. Rreth 400 vende të lira janë sot pranë FA-së për ushtarë dhe detarë aktivë. Procesi është i hapur për të gjithë të rinjtë apo të rejtat nga 18 deri në 27 vjeç me arsim 9-vjeçar, të mesëm apo të lartë.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Profesionalizmi i treguar dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD një strukturë profesionale dhe specialitet "niche", siç e quan NATO

Në mjesdjet e Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit të X-të EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përfortuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s, si pjesë e grupbatalionit kanadez të dislokuar në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu e shoqëruar edhe nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, Kolonel Përparim Gega.

Në përshëndetjen e saj drejtuar trupave, gjeneralmajor Shehu pasi adresoi një falënderim të veçantë për të gjithë burrat dhe gratë që shërbejnë në këtë njësi u shpreh ndër të tjera: "Ky është kontingjenti i X-të që shkon në mision në Letoni, nën drejtimin e Komandës së Grup Batalionit Kanadez. Profesionalizmi i treguar, trajnimet me aleatët dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD një strukturë të besueshme, profesionale dhe specialitet "niche" siç e quan NATO, për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë e aftë të kryejë detyra shumë të vështira. Jam besimplotë që personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës që i është ngarkuar dhe do të mbajë lart e me krenari flamurin kombëtar në Letoni.", -u shpreh gjeneralmajor Shehu.

Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin e X-të EOD, që nisët në Letoni dhe u mbyll me një

● Jam besimplotë që personeli i këtij kontingjenti do të mbajë lart e me krenari flamurin kombëtar në Letoni



Jemi krenarë për ju, për shërbimin ndaj vendit dhe Aleancës!

Të nderuar ushtarakë të kontingjentit të 11-të!
Të nderuar kolonel Gega dhe kolonel Gura!
Të dashur familjarë!

Më lejoni që në emrin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj dhe në emrin tim si zëvendëshef i Shtabit të Përgjithshëm, t'ju përshëndes në këtë ceremoni të përcjelljes së Kontingjentit EOD të Batalionit të Xhenios në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni.

Ky është kontingjenti i 11-të që shkon në mision në Letoni nën drejtimin e Komandës të Grup Batalionit Kanadez. Profesionalizmi i treguar, trajnimet me aleatët dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD një strukturë të besueshme, profesionale dhe specialitet "niche" siç e quan NATO, për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë e aftë të kryejë detyra shumë të vështira.

Shtabi i Përgjithshëm i FA-së dhe Ministria e Mbrojtjes ndjehen krenarë me ju, kur dëgjojmë vlerësimet pozitive nga homologët tanë gjatë takimeve të nivelit të lartë në NATO-s. E njëjta gjë u përcoll edhe nga SHSHP i Kanadasë, gjatë takimit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, ku u diskutua me vendet pjesëmarrëse në këtë grup batalion. Unë kam besim që edhe personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës që i është ngarkuar, dhe do të mbajë lart dhe me krenari

Fjala e zëvendës SHSHP të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, me rastin e nisjes së Kontingjentit të 11-të EOD në Letoni



flamurin kombëtar në Letoni.

Prezenca juaj atje nuk është vetëm realizimi i detyrave ushtarake, por ju jeni promovues të paqes dhe një mesazh i qartë ndaj kundërshtarëve të NATO-s për gatishmërinë e Shqipërisë për përmeshjen e Nenit 5-të NATO-s. Ndaj, imazhi juaj, realizimi i detyrave që nga ato rutinë dhe operacionale, kërkojnë një vëmendje të shtuar, gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm.

Gjithashtu, ju këshilloj të ndiqen me korrektesë procedurat standarde të veprimit dhe masat e sigurimit teknik në operacion për të shmangur ngjarjet e jashtëzakonshme dhe eliminimin e humbjes së jetës në operacione të tilla me rrezikshmëri të madhe jete.

Gjej rastin sot të falënderoj edhe personelin e batalionit të xhenios, për përgatitjen dhe krijimin e kushteve për stërvitje si ato me të cilët do të përballlet në Mision dhe zhvillimin me përgjegjësi

të stërvitjes së këtij kontingjenti.

Njësitë, repartet dhe trupa e xhenierëve janë dalluar ndër vite për punën e tyre të palodhur, të vështirë dhe me një rrezikshmëri të lartë. Kontributi juaj shtrihet jo vetëm në projektet në ndihmë të komunitetit nëpërmjet ndërtimit të urave, rrugëve, por deri tek kontrolli dhe pastrimi i territorit nga municione të periudhave të ndryshme e shkatërrimi i municioneve të tepërta të ushtrisë.

Gjej rastin të falënderoj të gjithë burrat dhe gratë që kanë shërbyer në këto njësi dhe shpreh respekt pafund për ata dëshmorë të këtij batalioni, të cilët kanë rënë në krye të detyrës në misionin e paqes në Letoni, siç është rasti i major Klodian Tanushit dhe nëntetares Zarife Hasanaj, të cilët mbeten nderi dhe krenaria juaj dhe e gjithë Forcave të Armatosura.

Në këtë rast, dëshiroj të përshëndes dhe të përgëzoj të gjithë ushtarakët që nisen me mision, duke i garantuar ata dhe familjarët e tyre se do të kenë në çdo rast mbështetjen dhe përkujdesjen e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes, për të arritur rezultatet më të mira në përmeshjen e misionit të tyre.

Së fundmi, ju po niseni pak përpara ndërrimit të viteve dhe besoj familjarët tuaj do ta ndiejnë mungesën tuaj gjatë festimeve të Vitit të Ri, por ata edhe ne jemi krenar për ju, për shërbimin ndaj vendit dhe Aleancës. Ndaj ju uroj Gëzuar Festat e Fundvitit dhe shëndet e suksese për vitin e ri 2022.

Ju faleminderit!

Portali "e-Albania", përfitimet e platformës dixhitale për ushtarakët

"E-Albania", portali që iu shërben të gjithëve, civilë dhe ushtarakë

Përfitimet e platformës dixhitale për ushtarakët

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve u mbajt një brifing njohës mbi funksionimin e Platformës dixhitale e-Albania.

Brifingu njohës u mbajt nga Toger Sonila Zhupani, në të cilin u fol mbi shërbimet që ofron e-Albania, benefitet që kemi ne nga shërbimet e ofruara nga kjo platformë e qeverisë dhe mënyrën sesi mund të aksesojmë për përdorimin e kësaj platforme, për të gjitha nivelet e shërbimit përkatës që ofron. Website e-Albania është kanali kryesor i marrjes së shërbimeve të administratës publike online për qytetarët, bizneset dhe vetë punonjësit e administratës publike, civilë dhe ushtarakë.

Për platformën dixhitale, në fjalën e tij të mbajtur për shtyp, ka folur dhe Kryeministri Rama, ku është shprehur se platforma ofron shërbime të shumta për qytetarët, duke reduktuar kohën e marrjes së shërbimit, duke evituar burokracitë, si dhe duke ulur korrupsionin.

Platforma dixhitale qeveritare e-Albania është tepër e domosdoshme për të gjithë ne, për shërbime të cilat mund t'i marrim përmes saj, lehtësisht dhe pa pasur nevojë të jemi fizikisht nëpër zyrat e administratave ku ofrohen këto shërbime, duke ndikuar kështu në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve.

E-Albania ofron shërbime publike në çdo orë dhe në çdo kohë, duke ofruar shërbime elektronike të nivelit të parë dhe të dytë, ku çdo i interesuar të marrë informacion të detajuar në lidhje me shërbimet për publikun. Gjithashtu ajo ofron shërbime elektronike të nivelit të tretë dhe të katërt nëpërmjet standardeve më të fundit të teknologjisë, si dhe mundësi për kryerjen e pagesave online për këto shërbime nëpërmjet kartave të debitit dhe kreditit.

Për ushtarakët, portali e-Albania ofron shërbime të shumta si: dëshmi penaliteti, vërtetim përmbartimi, aplikim për statusin e ushtarakut, vërtetim për periudhë pune në ndërmarrje shtetërore, pension shtetëror suplementar, shërbime shtetërore nga statusi dëshmor i atdheut.

Ky portal ofron gërshetimin e një sërë teknologjive të sigurisë për të mbrojtur të dhënat e përdoruesve. Procesi i regjistrimit kryhet nëpërmjet portalit qeveritar dhe të dhënat e plotësuara, nga përdoruesit gjatë procesit të regjistrimit, verifikohen elektronikisht me të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile për individët dhe Regjistrimit Kombëtar Tregtar për bizneset.

Platforma dixhitale e qeverisë e-Albania, në ditët e sotme po shndërrohet në kanalin kryesor mbi marrjen e shërbimeve online të administratës publike, ndaj familjarizimi me të është tepër i rëndësishëm.

Në mbyllje të brifingut u mor dhe feed-back nga të pranishmit ku u diskutua mbi mundësitë e ofrimit të shërbimeve online nga QAPN (si: listë notash kursantësh, certifikata etj.), përmes platformës qeveritare, e cila ngelet sfida dhe ambicia e së ardhmes së institucionit të QAPN-së.



● E-Albania ofron shërbime publike në çdo orë dhe në çdo kohë, duke ofruar shërbime elektronike të nivelit të parë dhe të dytë, ku çdo i interesuar të marrë informacion të detajuar në lidhje me shërbimet për publikun. Gjithashtu ajo ofron shërbime elektronike të nivelit të tretë dhe të katërt nëpërmjet standardeve më të fundit të teknologjisë, si dhe mundësi për kryerjen e pagesave online për këto shërbime nëpërmjet kartave të debitit dhe kreditit.



Betohen studentët e Bachelor-it dhe KPO-së



Në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtrisë (QAPU) Bunavi, Vlorë, u zhvillua ceremonia e betimit ushtarak të studentëve Bachelor të vitit të parë dhe studentëve të Kursit të Përgatitjes së Oficerit të Ri (KPO) pas përfundimit të stërvitjes bazë në QAPU.



Forcat Detare

96 vite histori mbi det

NGA SHEFQET KËRCELLI

Me shpalljen e pavarësisë, më 28 nëntor 1912, u bënë përpjekjet e para për organizimin e një flotilje të marinës nga Qeveria e Ismail bej Vlorës, por fillimi i Luftës së I-rë Botërore e ndërpreu këtë angazhim të qeverisë, si dhe mjaft aspekte të tjera të jetës social-ekonomike dhe politike.

Më 25 dhjetor 1925, mbërrinë nga Italia dy anije 190 tonë, të cilat u emërtuan me emrat domethënës “Shqipëria” dhe “Skënderbeg”. Këto anije u pajisën me efektivë marinarësh dhe u përdorën duke kryer detyra në interes të luftës kundër kontrabandës në brigjet shqiptare. Kjo datë shënon dhe Krijimin e Forcave Detare Shqiptare.

Më 24.06.1928, u krijua Komanda e Marinës në Durrës, me komandant, kapedan Ahmet Kapidani, dhe u mblodhën rekrutët e parë për këtë armë. Po këtë vit në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet qeverisë së asaj kohe dhe qeverisë italiane u sollën nga Venecia 5 (pesë) MV “Antisomergibile” të tipit “Elco” Amerikan, të cilat ishin përdorur gjatë Luftës së I-rë Botërore. (v.1917).

Me dekret të parlamentit, dt.16.11.1929, Struktura e Institucioneve Detare të Mbretërisë përbëhej nga: Komanda e Marinës, Skuadrilja me Motoskafë patrullimi tip “MAS”, Drejtoria Qendrore Detare dhe Kapitaneria e portit me 5 zyra, në Vlorë, Sarandë, Shëngjin, Himarë, dhe një në liqenin e Pogradecit.

Më 1934, u blenë po nga Italia edhe dy anije të tjera të lehta, të cilat u emërtuan “Saranda” dhe “Durrësi”, të destinuara kryesisht për luftën kundër kontrabandës në bregdetin tonë. (B. Fisher “Mbreti Zog dhe përpjekjet e tij për stabilizimin e gjendjes në Shqipëri”).

Pushtimi fashist më 7 Prill 1939, e ndërpreu këtë zhvillim të detarisë shqiptare, e cila po hidhte hapa të rëndësishme për krijimin e strukturave të organizuara me një fizionomi të qartë. Gjatë periudhës së Luftës së 2-të Botërore, pothuajse u rrënuar gjithçka nga këto anije. Ndaj, çlirimi i vendit e gjeti Flotën Shqiptare në gjendje të mjerueshme, me pothuajse të gjitha anijet të mbytura në portet, në bregdetin shqiptar, italian dhe dalmat.

Fillimi i vitit 1945, shënoi përpjekjet e para për riorganizimin dhe ringritjen e Forcave Detare. Kështu, më 23 shkurt 1945, pranë Komandës së Përgjithshme të UNÇLSH, u krijua Seksioni i Marinës Luftarake me shef seksioni, Kapiten i 1-rë, Abdi Mati. Nga dokumentacioni i kësaj komande vlejnjë për t’u përmendur urdhrat për thirrjen e oficerëve të marinës në detyrë, urdhër nr. 44. dt. 30.03.45, për riorganizimin e kantierëve të riparimit dhe funksionimin e kapitanerive të porteve nën kujdestarinë e seksionit të marinës, urdhër nr.82. dt.04.05, “Për rikthimin e barkave shqiptare që ndodheshin në Itali”, etj.

Më 15 gusht 1945, u bë përrurimi i hedhjes në ujë të dy motoskafëve trofe, me numër MS-10 dhe MS-12. Këto motoskafë u armatosën me mitraloz të lehtë dhe filluan patrullimin në ujërat tona bregdetare.

Në prill të 1946, u krijua Komanda e Marinës, kurse në Shëngjin, Durrës,



Sazan, Vlorë dhe Sarandë, krijohen grupet e ABD-së që vareshin prej saj. Në kuadrin e riorganizimit të MM, në shtator të v.1946, suprimohen Komandat dhe seksionet, midis të cilëve edhe seksioni i Marinës, pasi u krijua Drejtoria e Mbrojtjes Bregdetare.

Periodua e mëvonshme ka qenë një periudhë intensive, ku u punua me perspektivë për zhvillimin e FLD, duke shfrytëzuar edhe konjunkturën politike të kohës. Bëhet fjalë për lidhjet e bashkëpunimin në shumë fusha me vendet e ish-kampit socialist.

Në fillim të vitit 1949, Komanda e Marinës për çështje operative e të shërbimit kaloi në vartësinë e Komandës së Mbrojtjes Bregdetare, ndërsa për çështje të stërvitjes luftarake e teknike, ajo mbeti në vartësi të seksionit të Marinës në MMP.

Në vitet ‘53-‘54, u shënuar fillimi i një etape të re zhvillimi të FLD-së, me pajisjen e tyre me silur-hedhës e më vonë me Minaheqëse, Gjuajtës detarë dhe anije ndihmuese të llojeve të ndryshme. Më 27 janar 1954, u krijua skuadrilja autonome e KS-së, me qendër në ishullin e Sazanit, e cila e forcoi së tepërmi regjimin operativ për ruajtjen e ujërave tona detare.

Më 25 shtator 1957, u krijua Shërbimi Hidrografik, si strukturë tekniko-shkencore për sigurimin hidrolundrimor dhe të veprimeve luftarake, i cili përgatiti e ngriti një varg fenerësh në gjithë bregdetin. Ai njëkohësisht filloi përgatitjen e hartave detare shqiptare. U ngritën e modernizuan mjaft pika sinjal-vrojtuese dhe u pajisën ato me një rrjet të gjerë radiolokatorësh.

Në janar 1958, plot 13 vjet mbas krijimit të seksionit të marinës ushtarake në varësi Komandës së Përgjithshme dhe FUD, FLD u nda si njësi operative më vete që varej direkt nga Kom. Përgjithshme.

Më 5 mars 1958, erdhën nga Sevastopoli 4 GJDM, (tip Kronshtad, Pr122 B).

Në prill 1958, si rezultat i shtimit

të teknikës e anijeve, u bë riorganizimi i FD-së. Flota u shpëput nga vartësia e Brigadës së MBD dhe kaloi në vartësi të drejtpërdrejtë të MM-së, me qendër në Vlorë. Më 21 shtator 1958, u krijua Brigada e Nëndetësëve, (Br. ND). ND e 1-rë, (Whiski 613 C, Stuhia), ND e 2-të, (Rrufeja), ND e 3-të, (Vetëtima), ND e 4-të, (Tufani),

Në fund të v.1958, FLD kishte 20 anije luftarake, 4 ND, 4 GJDM, 6 MHV, 6 KS dhe 9 anije ndihmuese.

Më 1959, filloi nga puna Oficina e Riparimit të Anijeve në Pashaliman.

Më 8 janar të 1959, u krijua Brigada e Mbrojtjes së Rajonit të Ujërave (Brigada MRU), me qendër në ishullin e Sazanit, në përbërje të së cilës përveç gjuajtësve detarë u futën Minaheqëset e Bazës, të radës dhe skuadrilja e KS.

Në vitin 1961, me VKM Nr. 381, date 28.10.1961, në Vlorë u hap shkolla e Marinës, sot Shkolla e Trupës, (seksioni detar), e cila për mbi 4 dekada, ka luajtur rol kryesor në përgatitjen dhe furnizimin e FLD-së, FDT-së e NSH-së të Peshkimit, me qindra kuadro oficerë e specialistë, komandues e navigatorë, duke treguar një përgatitje e nivel të lartë profesional.

Periodua e viteve 1961-1980, shënoi zhvillimin e mëtejshëm të FLD-së, krijimin e vend-bazave të reja dhe disa reparteve të KS-së, kompletimin me anije luftarake moderne të kohës. U ngritën dhe modernizuan mjaft Pika Sinjal-Vrojtuese me një rrjet të gjerë radiolokatorësh.

Në shkurt të vitit 1962, ka një tjetër riorganizim të pjesshëm të njësive të dislokuara në bregdet, me krijimin e Komandës së FUD-it. Në këtë Komandë u inkuadrue edhe dega e Flotës e cila deri këtë vit ishte pranë MMP-së.

Më 21 shkurt 1968, FLD-së iu shtuan KS-të, të projektit të ri “Huchuan Pr 66-25”, të ardhur nga Kina.

Në mars 1968, u bë një tjetër riorganizim. Komandat e Flotiljeve pranë Korpuseve suprimohen dhe kriohen:

Flotilja 52 LD me qendër në Vlorë, dhe Flotilja 66 LD me qendër në Durrës. Me riorganizimin e ri, 2 Flotiljet kaluan në vartësi të MM-së.

Në 1973, për herë të parë në historinë e re të saj, FLD organizohet si njësi operative speciale në vartësi të drejtpërdrejtë nga Shtabi i Përgjithshëm, duke pasur në vartësi të saj të gjitha njësitë e BUD-eve, Br. ND, Shkollën e lartë të Marinës, Kantierin e Riparimit të anijeve, (KRAF), dhe 3 reparte speciale autonome.

Periodua e viteve 1980-’90, mund të konsiderohet si periudha e vijueshmërisë së lundrimeve, mbijetesës në drejtimin e sigurimin e gatishmërisë teknike të anijeve mbiujëse e nënujëse. Një kontribut të madh në këtë drejtim ka dhënë edhe Kantieri Detar i Riparimit të anijeve në Pashaliman.

Mbas viteve ‘90, për FD-në shtrohej detyra e ristrukturimit, rikonceptimit të reparteve të saj për një integrim të natyrshëm me strukturat e NATO-s dhe BE-së. Në këtë periudhë vlen për t’u theksuar mbështetja që dhanë efektivat e FD-së për proceset demokratike në vend, falë pjekurisë politike, shpirtit atdhetar e demokrat të kuadrove e efektivëve të FD-së. U rrit në mënyrë të ndjeshme bashkëpunimi me Flotat e vendeve të NATO-s, ku u zhvilluan me sukses mjaft stërvitje të përbashkëta si “SAR-EX-1”, “SAR-EX-2”, “MAR-EX-1”, “MAR-EX-2” etj., në të cilat kuadrot tanë treguan një nivel profesional të vlerësuar nga partnerët.

Në mars 1993, bazën e Kepit të Palit e vizitoi ish sekretari i Mbrojtjes i NATO-s,

Manfred Vërner.

Në korrik v.1993, BUD-i i Durrësit e i Vlorës u emërtuan Distrikte Detare, ndërsa Shëngjini e Saranda ngelën po BUD-e.

Në tetor 1995, u bë riorganizimi i Forcave Detare mbi bazën e Distrikteve Detare, Durrës e Vlorë, si dhe Bazave Ndihmuese Sarandë e Shëngjin. Në përbërje të tyre u futën dhe Bateritë e

Artilerisë Bregdetare e K/Ajrore, në nivel batalioni. FLD-të u emërtuan FMD, Forcë e Mbrojtjes Detare.

Ngjarjet tronditëse të marsit 1997, shkaktojnë në repartet e FMD-së, dëme shumë të mëdha e gati të pallogaritshme. Pjesa më e madhe e anijeve, me qëllim që t’i shpëtonin valës të shkatërrimeve, lundroi e u strehua në Brindisi të Italisë. Sipas marrëveshjes së përbashkët të dy shteteve, pas riparimit të tyre u kthyen në Shqipëri. Gjysma e dytë e vitit 1997 dhe viti 1998 shënoi një etapë ringritjeje dhe riorganizimi të reparteve të FD-së pas dëmeve të pësuar. Kështu pas një pune intensive, falë përkushtimit maksimal të kuadrove e efektivëve të FD-së, u bë e mundur ringritja dhe funksionimi i DD-së të Durrësit e Vlorës, si dhe BnD-së Sarandë e Shëngjin. Vlen për t’u përmendur në këtë proces ringritjeje, ndihma e partnerëve tanë perëndimorë si SHBA, Itali, Turqi, Greqi, etj.

Më 1998, si rezultat i kohës së gjatë të përdorimit, pas një veprimtarie 40-vjeçare, dolën jashtë strukturave luftarake të FD-së, të 4 ND-et e saj.

Në mars të vitit 1999, me ndihmën e Departamentit të Shtetit të SHBA-së, FD-të u pajisën me 5 motovedeta patrulluese, (3 copë të klasit-65 foot, dhe 2 copë-46 foot), të cilat u bënë protagoniste të operacioneve SAR dhe zbatimit të ligjshmërisë detare në këto 15 vite.

Në 2001, Komanda e Forcave Detare deri në këtë kohë në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes, u vendos në Plepa, Durrës.

Në 2002, me kontributin e qeverisë italiane, pas miratimit të Ligjit të Rojës Bregdetare Shqiptare, Nr. 8875, (dt. 04.04.2002), FD-të u pajisën dhe me 6 motovedeta (MV të klasit 200 foot) nga Italia, të cilat së bashku me MV amerikane rritën aftësitë operacionale të Rojës sonë Bregdetare, në luftën dhe përpjekjet kundër trafikeve të paligjshme në det.

Në gusht 2002, 14 anije të FD-së morën pjesë në operacionin e gjerë antitrafik “PUNA”, në bashkëpunim me organet e rendit, të anti-kontrabandës, peshkimit, etj., duke bërë të mundur zvogëlimin e këtij trafiku.

Më 30 maj 2003, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë, u zhvillua Konferenca e 1-rë e Rojës Bregdetare, me pjesëmarrjen e disa Ministrive, ku u përcaktua vizioni dhe strategjia për të ardhmen e FD-së, dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera që kanë interesa në det.

Më 12-23 shtator 2005, në rajonin e Gjirit të Vlorës u zhvillua stërvitja më e madhe e përbashkët detare “Cooperative Engagement-05”, me pjesëmarrjen e Flotave të 14 vendeve të ndryshme të botës. Forca jonë Detare mori pjesë me 19 anije të tipave të ndryshëm.

Në fillim të vitit 2007, Forca Detare kaloi në strukturën e re, Brigadë Detare me dy Flotilje (FDV E FDJ), dhe një Batalion Logjistik (mbështetje).

Në shkurt 2007, filloi puna për instalimin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, (SHVD), projekt i zbatuar nga firma prestigjioze Amerikane “Lockheed-Martin”.

Në nëntor të vitit 2007, u nënshkrua marrëveshja me Mbretërinë e Holandës (Kantierin Damen Shipyard), për pajisjen e FD-së me 4 anije patrulluese.

Nga data 1-5 Mars 2008, 5 anije të Grupit të 2-të Detar të NATO-s,

96 vjet Forca Detare

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia: Forca Detare ka kryer me sukses detyrat e ngarkuara kombëtare, rajonale apo edhe në kuadër të Aleancës

Doktrina e Forcës Detare, si pjesë e Doktrinës së FARSH ka karakter mbrojtës, i cili sanksionohet në qëllimin parësor strategjik të FARSH, që është: “Ushtrimi i sovranitetit të Republikës së Shqipërisë; Mbrojtja e pavarësisë dhe integritetit territorial; Mbrojtja e jetës dhe e pasurisë së shtetasve, zhvillimi i pandërprerë demokratik dhe prosperiteti ekonomik; Mbrojtja e dinjitetit dhe e vlerave kombëtare; si dhe integrimi i plotë në strukturat ndërkombëtare të sigurisë, në Organizatën e Atlantikut të Veriut (NATO) e në Bashkimin Evropian (BE)”. Në 96 vite të krijimit të saj, Forca Detare ka realizuar me përpikëri të lartë detyrën e saj. Në aktivitetin e organizuar për të kujtuar ata njerëz që hodhën bazat e themelimit të kësaj force ishin të pranishëm dhe zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandantë të forcave, ish-komandantë të Forcës Detare ndër vite, prefekti i qarkut z. Roland Nasto si dhe personel i Forcës Detare. Komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni, pasi vlerësoi punën e bërë ndër vite të gjithë personelit që ka shërbyer dhe shërben në këtë forcë, u shpreh ndër të tjera se “Forca Detare, si rezultat i rritjes së ndjeshme të kapaciteteve të saj operacionale, vitet e fundit ka kryer me sukses detyrat të cilat i janë ngarkuar, qofshin ato kombëtare, rajonale apo edhe në kuadër të Aleancës. Forca Detare përfaqësoi me sukses vendin tonë gjatë pjesëmarrjes me anijen e klasit “Iliria”, në aktivitetin



“Angazhimi disavjeçar në misionin e NATO-s në detin Egje, gjatë të cilit janë shpëtuar mijëra jetë njerëzish, është një eksperiencë dhe një medalje nderi për Forcën Detare, një vlerë për Forcat e Armatosura dhe një krenari e dinjitet për vendin”, -u shpreh zv/ministrja e Mbrojtjes.

e NATO-s në detin Egje, duke u radhitur të barabartë me kolegët e tyre të NATO-s. Një përshëndetje e veçantë në ceremoni u adresua edhe nga zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Dallëndyshe Bici, e cila e konsideroi këtë ditë si një homazh dhe nderim për punën dhe veprën e të gjithë brezave që kanë shërbyer ndër vite në

Forcën Detare. “Angazhimi disavjeçar në misionin e NATO-s në detin Egje, gjatë të cilit janë shpëtuar mijëra jetë njerëzish, është një eksperiencë dhe një medalje nderi për Forcën Detare, një vlerë për Forcat e Armatosura dhe një krenari e dinjitet për vendin”, -u shpreh zëvendësministria e Mbrojtjes.

(SNMG2), me qendër në Napoli, zhvilluan një vizitë portuale në vendin tonë. Qëllimi i kësaj vizite ishte forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e mirëkuptimit midis vendit tonë dhe strukturave të NATO-s. Ky grup detar viziton çdo vit portin e Durrësit dhe Vlorës.

Më datë 5 Shtator 2008, në molin nr.5 të Portit të Durrësit u zhvillua ceremonia e përvitit të anijes “Iliria”, P-131, e cila mbërriti në Shqipëri në kuadër të zbatimit të kontratës me Kompaninë Holandeze “Damen Shipyards”.

Në mars 2009, mbasi u zhvilluan provat finale, u mor në dorëzim nga përfaqësues të MM-së e FD-së, Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare, i instaluar nga specialistët e kompanisë “Lockheed Martin”, i cili aktualisht përbën asetin më të rëndësishëm të zbulimit e vëzhgimit të hapësirës sonë detare, për të gjitha ministritë tona që mbulojnë kufirin blu.

Në fillim-vitin e 2010-ës, me organizimin e ri, Komanda e FD-së, zhvendoset tek ish-konvareshenca e Ushtrisë, SHPU, pasi atje u vendos QNOD.

Më datë 2 shtator 2010, në portin e Durrësit u zhvillua ceremonia e marrjes në dorëzim të 3 anijeve patrulluese “ARCHANGEL”, dhuratë e Departamentit të Shtetit të SHBA-së. Në sajë të parametrave teknikë dhe ushtarakë “ArchAngel” janë në gjendje të zhvillojnë operacione të suksesshme për zbatimin e ligjshmërisë detare si dhe operacione SAR.

Gjatë këtyre viteve, me mbështetjen e partnerëve tanë të NATO-s, veçmas SHBA-së, si dhe nën kujdesin e qeverisë dhe popullit shqiptar, Forca Detare ka bërë hapa para për realizimin e misionit kushtetues, mbrojtjen dhe zbatimin e ligjshmërisë detare, mbajtjen në kontroll të kësaj hapësire nëpërmjet Sistemit të Ri

të Vëzhgimit të saj si dhe krijimin e kapaciteteve të nevojshme operacionale për planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve humanitare në ndihmë të komunitetit. Duke mbajtur një prezencë të përhershme dhe aktive në det, Forca Detare është tashmë një aktor i rëndësishëm dhe i vlerësuar nga opinioni, shteti shqiptar dhe partnerët tanë. Ndërkohë anëtarësimi i vendit tonë në NATO, solli nevojën e një teknologjie ndërvepruese e efikase me partnerët e FD-s dhe hartimin e një plani modernizimi racional, mbështetur në burimet ekonomike që afronte shteti shqiptar. Ky plan transformimi përfshiu modernizimin e FD-së me sisteme, pajisje e mjete detare, të shtrira në plane afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, ku prioritet ka qenë kompletimi me mjete të reja që kryejnë misionin e Rojës Bregdetare. Në dekadën e fundit pajisja e FD-së me katër anije patrulluese të mëdha, në kuadër të zbatimit të kontratës me Kompaninë Holandeze “Damen Shipyards”; me Motovedeta të shpejta dhe anije anti-ndotje, dhuratë e Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-së dhe qeverisë italiane; ndërtimi i Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare nga firma prestigjioze Amerikane “Lockheed-Martin”, pajisja me sisteme të vëzhgimit natën dhe sistemin AIS të anijeve të Rojës Bregdetare, përmirësimet infrastrukturorë të vendbazeve detare, etj., janë hapa konkretë në zbatim të këtyre politikave zhvillimore të Forcës Detare.

Në këtë kuadër projekti më i rëndësishëm për modernizimin e FD-së, ishte nënshkrimi, më 13 nëntor 2007, i marrëveshjes për pajisjen e FD-së me 4 anije Patrulluese STAN PETROL-4207. Ky projekt bëri të mundur që 6 vjet më parë, më 5 Shtator 2008, në molin Nr. 5 të Portit të Durrësit të bregëzohet anija “Iliria”, (P-131), një trashëgimtare e

denjë e “Liburnes” dhe “Lembes” ilire. Në vijim, më 14 Maj 2009, filloi ndërtimi i anijes “Oriku”, (P-132), e cila u lëshua në ujë më 13 shtator 2011 dhe më 3 dhjetor 2012, u lëshua në ujë anija e tretë, (P-133) “Lissus”. Ndërkohë më 8 prill 2014, u lëshua në ujë anija e katërt, “Butrinti” (P-134), që shënon dhe përfundimin e këtij projekti.

Nga viti 2006, FD është pjesëmarrëse në iniciativën dhe stërvitjen rajonale “ADRIJON”, ku në 3 vite ka qenë mikpritëse e kësaj stërvitje.

Në vitet 2016-2019, FD mori pjesë në operacionin e NATO-s “SEA GUARDIAN”, në Detin Mesdhe, për ndalimin e emigracionit të paligjshëm në këtë rajon, duke shpëtuar mbi 3500 persona, kryesisht gra dhe fëmijë.

Ndërkohë Qendra e zhytjes e FD-së ka zhvilluar dhjetëra operacione në ndihmë të komunitetit dhe operacione EOD në bregdetin shqiptar, kryesisht Vlorë e Sazan.

Shërbimi Hidrografik i FD-së, në bashkëpunim me palën norvegjeze, nëpërmjet projektit “ALNO-HIP”, ka grumbulluar dhe përpunuar informacione batimetrike, me qëllim krijimin dhe përditësimin e hartave detare dhe informacioneve lundimore për detarët shqiptarë. Po, ashtu SHSH mban në gatishmëri sinjalistikën detare për lundrim të sigurt të mjeteve detare.

Sistemi i SIHVD, siguron komunikim dhe të dhëna për FD-në, FA-të dhe institucionet e tjera me interesa në det. Tashmë, nga viti i kaluar iu rikthye bashkëpunimit me kompaninë prestigjioze “Lockheed Martin”, për të mbajtur gatishmërinë e sistemit dhe modernizuar atë hap pas hapi.

Në realizimin e misionit dhe detyrave të saj në det, FD bashkëpunon me institucionet e tjera që kanë interesa në det, si Drejtorinë e Administratës Detare dhe Kapitaneritë e Porteve, Portet Detare, Policinë Kufitare, Anti-kontrabandën

detare, Agjencitë e peshkimit, RDSH, etj.

Në të ardhmen, FD synon përgatitjen e bazës së Pashalimanit për ta bërë atë pjesë të NATO-s, pajisjen me anije patrulluese, të afta për çdo operacion të NATO-s, etj.

Modernizimi i FD-së me pajisje, sisteme dhe anije për të zëvendësuar teknikën e vjetër me teknikë moderne e bashkëkohore, të ndërveprueshme me NATO-n, me qëllim rritjen e kapaciteteve operacionale për realizimin e misionit dhe detyrave të përcaktuara në ligj, janë hapa konkretë në zbatim të këtyre politikave zhvillimore e transformuese të këtyre viteve të fundit. Theksojmë se historikisht, përbërja, struktura dhe mjetet që kanë pasur në dispozicion Forcat Detare kanë ecur paralel me zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit dhe mundësitë financiare të shtetit shqiptar, një mbështetje e cila ka qenë e vazhdueshme në këto 96 vjet ekzistencë.



MSC. MIMOZA GOLIKJA

Franca merr drejtimin e forcës më të lartë të gatishmërisë së NATO-s

VJTF kontribut thelbësor për mbrojtjen aleate

Franca merr drejtimin e forcës ushtarake të gatishmërisë më të lartë të NATO-s në datën 1 janar 2022, që do të zgjasë për një vit. Formacioni, i njohur zyrtarisht si Task Forca e Përbashkët e Gatishmërisë Shumë të Lartë të NATO-s (VJTF), u krijua në vitin 2014 në përgjigje të krizave në Lindjen e Mesme dhe agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, dhe është i disponueshëm përgjithmonë për të lëvizur brenda disa ditësh për të mbrojtur çdo aleat. VJTF është elementi i gatishmërisë më të lartë të Forcës së Reagimit prej 40,000 trupash të NATO-s.

“Falënderoj Francën për udhëheqjen e forcës së reagimit të shpejtë të NATO-s në vitin 2022,” -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. “Task Forca e Përbashkët e Gatishmërisë Shumë të Lartë është një kontribut thelbësor për mbrojtjen tonë kolektive dhe udhëheqja e Francës është një shfaqje e fortë e angazhimit dhe aftësi. Në një kohë sfidash të paprecedentë të sigurisë, nuk duhet të ketë asnjë keqkuptim për vendosmërinë e NATO-s: Ne qëndrojmë së bashku për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët”, -shtoi Stoltenberg.

Në vitin 2022, VJTF do të përbëhet nga një forcë shumëkombëshe prej disa mijëra trupash. Brigada franko-gjermane prej 3500 trupash do të shërbejë si bërthama e forcës, duke u mbështetur në Regjimentin e Parë të Këmbësorisë dhe Regjimentin e 3-të Hussar. E udhëhequr nga Korpusi i Reagimit të Shpejtë të Francës në Lille, brigada franko-gjermane është një njësi dykombëshe, duke nënvizuar lidhjen e fortë midis aleatëve të NATO-s, Gjermanisë dhe Francës. Vende të tjera të NATO-s, përfshirë Spanjën, Portugalinë dhe Poloninë do të ofrojnë forca gjithashtu. Pjesa më e madhe e forcës përbëhet nga njësi të brigadës kryesore. Udhëheqja e VJTF, e cila vendos ushtarët në status të lartë gatishmërie dhe gati për t'u vendosur brenda disa ditësh, rrotullohet çdo vit midis aleatëve. Franca e merr drejtimin nga Turqia, e cila drejtoi forcën në vitin 2021, kurse Gjermania do të drejtojë njësinë pas Francës në vitin 2023. Komanda e forcave të përbashkëta të NATO-s në Brunssum, Holandë, mban komandën për të gjithë Forcën e Reagimit të NATO-s në 2022.

Plani i Veprimit të Gatishmërisë

Plani i Veprimit të Gatishmërisë (RAP) ka qenë një moment historik dhe shtytës thelbësor i përshtatjes ushtarake të NATO-s ndaj mjedisit të ndryshuar dhe në zhvillim të sigurisë. I rënë dakord në Samitin e Uellsit të vitit 2014, RAP nisi përfundimin më të rëndësishëm të mbrojtjes kolektive të NATO-s që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Në Samitin e Varshavës 2016, udhëheqësit aleatë përshëndetën zbatimin e tij dhe ranë dakord që kjo paketë gjithëpërfshirëse e masave të sigurimit dhe përshtatjes tani përbën bazën e qëndrimit parandalues dhe mbrojtës të Aleancës. Për shkak të ndryshimit të mjedisit të sigurisë në kufijtë e NATO-s që nga viti 2014, RAP përfshin masa sigurie për aleatët e NATO-s në Evropën Qendrore dhe Lindore për të siguruar popullsinë e tyre, për të përfunduar mbrojtjen e tyre dhe për të penguar agresionin e mundshëm.

Masat e sigurimit përfshijnë një seri aktivitetesh tokësore, detare dhe ajrore në, mbi dhe rreth territorit të aleatëve të NATO-s në Evropën Qendrore dhe Lindore, të dizajnuara për të përfunduar mbrojtjen e tyre, siguruar popullsinë dhe për të penguar agresionin e mundshëm. Këto masa janë rezultat i drejtpërdrejtë i veprimëve agresive të Rusisë në lindje të NATO-s. Të gjithë aleatët e NATO-s po kontribuojnë në këto masa në bazë të rotacionit. Masat mund të rriten ose



zvogëlohen sipas nevojës, në varësi të situatës së sigurisë. Që nga maji 2014, NATO ka rritur numrin e avionëve luftarakë në patrullimet e policisë ajrore mbi shtetet baltike dhe ka vendosur avionë luftarakë në Bullgari, Rumani dhe Poloni. Në dhjetor 2015, u ra dakord për një paketë të mëtejshme masash sigurie të përshtatura për Turqinë. Aleanca kryen fluturime të rregullta vëzhgimi AWACS mbi territorin e aleatëve të saj lindorë dhe fluturime të avionëve të patrullimit detar për gjatë kufijve lindorë të territorit aleat. Për të ofruar siguri në det, NATO vendos një numër forcash detare shumëkombëshe, si dy Grupe të Përhershme Kundërmasash të Minave të NATO-s që patrullojnë Detin Baltik dhe Mesdheun Lindor, dhe një Grupi i Përhershëm Detar i NATO-s i zgjeruar që kryen masa sigurimi detar përveç patrullimeve kundër terrorizmit. NATO ka rritur numrin e stërvitjeve që organizon. Stërvitjet ushtarake ofrojnë mundësi të rëndësishme për të përmirësuar aftësinë e aleatëve dhe partnerëve për të punuar së bashku dhe janë një demonstrim i vlefshëm i gatishmërisë së NATO-s për t'iu përgjigjur kërcënimeve të mundshme. Këto ushtrime zhvillohen në tokë, në det, në ajër dhe në hapësirën kibernetike me skenarë të bazuar në mbrojtjen kolektive dhe menaxhimin e krizave. Masat e sigurisë janë fleksibël dhe të shkallëzueshme në përgjigje të situatës në zhvillim të sigurisë dhe mbahen nën shqyrtim vjetor nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, organi kryesor vendimmarrës politik i NATO-s. Masat e përshtatjes janë ndryshime afatgjata në forcat dhe strukturën komanduese të NATO-s, të cilat do ta bëjnë Aleancën më të aftë për të reaguar me shpejtësi dhe vendosmëri ndaj krizave të papritura. Ato përfshinin trefishimin e përmasave të Forcave të Reagimit të NATO-s (NRF), krijimin e një Force të Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë (VJTF) të aftë për t'u vendosur në një njoftim shumë të shkurtër dhe forca të përhershme detare të zgjeruara. Për të lehtësuar gatishmërinë dhe vendosjen e shpejtë të forcave, u krijuan në Evropën Qendrore dhe

Lindore tetë Njësi të Integritit të Forcave të NATO-s (NFIU), të cilat janë shtabe të vogla. U krijuan gjithashtu selia për Korpusin Shumëkombësh Verilindor në Szczecin, Poloni dhe Divizionin Shumëkombësh Juglindor në Bukuresht, Rumani. Përveç kësaj, u krijua një seli e përbashkët e grupit të mbështetjes logjistike.

Forca e Reagimit e zgjeruar e NATO-s (NRF) është një forcë shumëkombëshe shumë e gatshme dhe e avancuar teknologjikisht e përbërë nga komponentë tokësorë, ajrorë, detarë dhe të Forcave të Operacioneve Speciale (SOF) që Aleanca mund t'i vendosë shpejt, kudo që të jetë e nevojshme. Në Samitin e Uellsit të vitit 2014, aleatët vendosën të përmirësojnë NRF-në për të forcuar mbrojtjen kolektive të Aleancës dhe për të siguruar që NATO të ketë forcat e duhura në vendin e duhur në kohën e duhur. NRF përbëhet nga rreth 40,000 personel, një rritje e madhe nga niveli i mëparshëm prej 13,000. Madhësia e saj varet nga detyra për të cilën nevojitet. Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR) ka komandën e përgjithshme të NRF-së. Çdo vit me rotacion, dy Komandat e Forcave të Përbashkëta të NATO-s (me bazë në Brunssum, Holandë dhe Napoli, Itali) kanë komandën operacionale të NRF-së.

Task Forca e Përbashkët me Gatishmëri Shumë të Lartë, me reagim të shpejtë (VJTF), një “forcë majë shtize” prej rreth 20,000 trupash, nga të cilat rreth 5,000 janë forca tokësore, është në gjendje të fillojë vendosjen brenda dy deri në tre ditë kudo që të jetë e nevojshme. VJTF mbështetet nga komponentët ajror, detar dhe SOF. Udhëheqja dhe anëtarësimi i VJTF dhe NRF rrotullohen në baza vjetore. Forcat e VJTF dhe NRF janë të vendosura në vendet kryesore, por në gjendje të vendosen prej andej kudo që nevojiten për stërvitje ose reagim ndaj krizave. VJTF, e cila mori pjesë në stërvitjen e saj të parë të vendosjes në Poloni në qershor 2015, testohet rregullisht gjatë stërvitjeve.

Njësitë e Integritit të Forcave të NATO-s (NFIU), janë shtabe të vogla shumëkombëshe që lehtësojnë vendosjen e shpejtë të VJTF-së dhe

forcave aleate pasuese. Ato kanë rreth 40 specialistë kombëtarë dhe të NATO-s. Detyra e tyre është të përmirësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet NATO-s dhe forcave kombëtare, si dhe të përgatisin dhe mbështesin stërvitjet dhe çdo vendosje të nevojshme. Së pari, gjashtë NFIU u krijuan në Bullgari, Estoni, Letoni, Lituani, Poloni dhe Rumani dhe u inauguruan në shtator 2015, duke përbërë një prani të dukshme dhe të vazhdueshme të NATO-s në këto vende. Më pas, u inauguruan dy NFIU të tjera në Hungari dhe Sllovakia, përkatësisht, në shtator 2016 dhe janar 2017. Shtabi i Korpusit Shumëkombësh Verilindor (HQ MNC-NE), i vendosur në Szczecin, Poloni ofron një aftësi të lartë gatishmërie për të komanduar forcat e dislokuara në Shtetet Baltike dhe Poloni, nëse kërkohet. Themeluar nga Danimarka, Gjermania dhe Polonia, HQ MNC-NE ka katër detyra kryesore, komandimi i VJTF-së dhe NRF-së, ose elementeve të tyre, nëse dislokohen në rajonin verilindor të NATO-s; ushtrimin e kontrollit operacional mbi NFIU-të në Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni dhe Sllovakia; monitorimin e situatës së sigurisë në rajon; dhe duke vepruar si qendër rajonale për bashkëpunim. Një seli e re divizioni shumëkombëshe e dislokueshme për juglindjen u përfundua në Bukuresht, Rumani më 1 dhjetor 2015. Shtabi i gatishmërisë së lartë është në gjendje të komandojë forcat e dislokuara brenda rajonit juglindor të NATO-s, duke mbështetur mbrojtjen e Aleancës. HQ MND-SE, i cili arriti aftësinë përfundimtare operacionale më 22 mars 2018, ekzekuton komandën dhe kontrollin mbi NFIU-të në Bullgari dhe Rumani. Përveç kësaj, RAP bën thirrje për një sërë përmirësimesh logjistike, përfshirë paracaktimin e pajisjeve dhe furnizimeve, për të rritur gatishmërinë e NATO-s për t'iu përgjigjur çdo sfide për sigurinë aleate. Brenda Strukturës së Komandës së NATO-s u krijua një seli e re e grupit të përbashkët të mbështetjes logjistike.

Ja si ka evoluar Plani i Veprimit të Gatishmërisë

Në shtator 2014, në Samitin e NATO-s në Uells, liderët aleatë miratuan Planin e Veprimit të Gatishmërisë për të siguruar që Aleanca të jetë gati për t'iu përgjigjur me shpejtësi dhe vendosmëri sfidave të reja të sigurisë. Plani ofronte një paketë gjithëpërfshirëse masash për t'iu përgjigjur ndryshimeve në mjedisin e sigurisë në dhe afër Evropës dhe ndaj kërcënimeve që vijnë nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut. Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s vendosën më 5 shkurt 2015 që VJTF do të përbëhet nga një komponent tokësor prej rreth 5,000 trupash me njësi të përshtatshme ajrore, detare dhe SOF në dispozicion. Franca, Gjermania, Italia, Polonia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar ranë dakord të marrin rolet kryesore për VJTF-në me rotacion në vitet e ardhshme. U vendos gjithashtu për të pasur një VJTF të aftë operacionalisht deri në Samitin e Varshavës 2016, gjë që u arrit. Në prill 2015, më shumë se 1,500 trupa morën pjesë në

